

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-23-0099****Në ankesën e****Paditësi****N B**, fshati K, Podujevë.**Kundër****E paditura/Ankuesja**

NSH, FAN "Zahir Pajaziti" Podujevë (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-4096 të datës 13 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-4096 të datës 13 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 15 maj 2014, paditësi përmes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0280 i datës 14 prill 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për pagesën e pagave të pa paguara për periudhën nga muaji dhjetor 2002 e deri në dhjetor 2004 në shumën prej 2,420.00 euro, kundër Vendimit PRN046-0282 të datës 14 prill 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë të paspecifikuar, dhe kundër Vendimit PRN046-0281 të datës 14 prill 2014, me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për pagesën e tri pagave të fundit të pa paguara në shumë prej 1,255.87 euro. Autoriteti i Likuidimit në vendimet e ankimuar ka konstatuar se paditësi nuk e ka dorëzuar kërkesat në afatin prej 3 vitesh, andaj në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar kërkesat për paga dhe për ndërprerje të marrëdhënies së punës janë parashkruar. Në ankesë paditësi ka pohuar se në NSH ka punuar që nga viti 1999 deri më 02.05.2009. Në ankesë paditësi i kundërshton konstatimet e Autoritetit të Likuidimit se kërkesat e tij për paga dhe për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës janë parashkruar. Paditësi pohon se ai ka pranuar njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës nga ana e AKM-së me datë 24 mars 2006, dhe bazuar në këtë njoftim kur ka filluar procedura e likuidimit ndaj NSH-së i ka paraqitur të tri kërkesat tek Autoriteti i Likuidimit, të cilat pa ndonjë bazë ligjore janë refuzuar. Ai pohon se në NSH ka një përvojë pune mbi 21 vite dhe i takojnë pagat e papaguara si dhe kompensimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të privatizimit të saj. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka bashkangjitur kopjen e Njoftimit të datës 24 mars 2006 e lëshuar nga AKM-ja mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës duke filluar nga data 24 mars 2006, Kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 24.03. 2006, Një liste të pagave të pa paguara të lëshuar nga ana e NSH-së, Listën për tri pagat e fundit të pa paguara, tre formularët e kërkesave dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit, kopjen e letërnjoftimit, dhe kopjet e tri Vendimeve të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 12 dhjetor 2022, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka sjellë dëshmi për të vërtetuar se ai këto paga i ka kërkuar më herët në ndonjë gjykatë kompetente, andaj kërkesat janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se ankuesi nuk ka paraqitur në ankesën e tij i cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja pohon se njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës nuk mundet të konsiderohet asnjëherë si pranim i borxhit, duke pohuar se kjo letër ka të bëjë me realizimin e të drejtës nga lista për 20%. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohen vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 13 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-4096, e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar dhe i ndryshon vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit, si dhe e obligon AKP-në që në emër të pagave të pa paguara për periudhën për muajin mars 2003-mars 2006 ,ti paguaj paditësit shumën prej 1,417.73 euro, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës për tej shumës së aprovuar e refuzon si të pa bazuar. Me pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit po ashtu obligohet AKP-ja që ti paguaj paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës shumën prej 567.28 euro, si dhe në emër të tri pagave të fundit të papaguara shumën prej 1,255.87 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësi ishte punëtor i NSH-së Fan"Zahir Pajaziti" në Podujeve deri me 24 mars 2005, kur është privatizuar ndërmarrja, dhe se ai ka të drejtë pjesërisht në pagat e pa paguara për muajin mars 2003-mars 2006 ,në shume prej 1,417.00 euro, pasi që ai pagën e fundit të papaguar e kishte në shumë prej 393,26 euro. Pjesa tjetër e kërkesës për paga për periudhën e mëhershme është parashkruar, andaj ajo duhet refuzuar për tej pjesës së aprovuar.

Tutje shkalla e I-rë konstaton se me rastin e llogaritjes së tri pagave të papaguara, ajo është bazuar në Listën e pagave të mbetura borxh e datës 24 mars 2006. Shkalla e I-rë konstaton se paditësit i është njohur e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 567.28 euro, bazuar në përvojën e tij të punës prej 21 viteve e 11 muaj sipas kopjes së Librezës së punës, ku paga mujore e tij ishte 393.26. Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësi e kishte pranuar nga AKM-ja njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies se punës me datë 24 mars 2006, kur edhe është privatizuar NSH-ja dhe se ky njoftim e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës. Në njoftim thuhej qarte se shumet-pagat që iu janë borxh juve sipas kontratës tuaj te punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave te likuidimit dhe ju do te kontaktoni kur te fillojnë këto procedura. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se bazuar në këtë njoftim dhe udhëzimeve te dhëna në te, paditësi e ka prit fillimin e procedurës se likuidimit ndaj NSH-së dhe me datë 30 shtator 2013 i ka paraqitur të tri kërkesat për paga tek Autoriteti i Likuidimit. Shkalla e I-rë konstaton se pagat e kërkuara për muajin dhjetor 2002 dhe janar dhe shkurt 2003 janë parashkruar pasi që njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës për këto 3 paga të kësaj periudhe nuk e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës meqë kishte kaluar afati mbi 3 vite i parashkrimit të kërkesës.

Me datë 15 shkurt 2023, e paditura (në tekstin e mëtejme ankuesja) në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-4096 të datës 13 janar 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet ankesa e paditësit e paraqitur ndaj vendimeve të ankimuara të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të

drejtës së pretenduar- afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja pretendon se kërkesa për pagesën e pagave për periudhën dhjetor 2002 –dhjetor 2005 është dashtë të paraqitet në afatin prej 3 viteve, gjë që në këtë rast nuk ka ndodh. Po ashtu kërkesa për tri paga të pa paguara si dhe kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës po ashtu janë parashkruar, pasi që ato nuk janë paraqitur në afatin prej tri viteve siç kërkon neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 18 prill 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtesë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtesë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. Paditësi në këtë parashtesë pohon se pretendimi i AKP-së se kërkesa është parashkruar është pretendim i pa bazuar. Ai pohon se si punëtor i NSH-së dhe ka punuar në NSH-në deri në ditën e privatizimit me 24 mars 2006. NSH për pagat e pa paguara që i përkasin periudhës së cekur është përgjegjëse ti paguaj, pasi që ajo nuk i ,ka paguar. Tutje ai pohon se në NSH ka punuar më shumë se 21 vite dhe se ka të drejtë edhe në kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, dhe në kompensim për tri pagat e fundit të papaguara. Paditësi pohon po ashtu se ai ka pranuar njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies se punës nga ana e AKM-së me datë 24 mars 2006, dhe bazuar në këtë njoftim kur ka filluar procedura e likuidimit ndaj NSH-së i ka paraqitur të tri kërkesat tek Autoriteti i Likuidimit, të cilat pa ndonjë bazë ligjore janë refuzuar. Paditësi në këtë parashtesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 30 shtator 2013, i ka dorëzuar tri kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit, dhe ai ka kërkuar që të kompensohen pagat e pa paguara nga muaji dhjetor 2002 e deri në mars 2005 në shumë prej 2,420.00 euro, kërkesën për tri pagat e fundit të papaguara në shumë prej 1,255.87 euro, si dhe kërkesën për kompensim për ndërprerjeje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë të pa specifikuar.

Këto tri kërkesa janë refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së nuk e ka pranuar qëndrimin ligjor të Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për paga tërësisht është parashkruar. Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësi ka sjellë prova të mjaftuara që vërtetojnë se ai ishte punëtor i NSH-së deri në privatizimin e saj me 24 mars 2006, si dhe prova për lartësinë e kërkuar të kompensimit, andaj duke u bazuar në këto prova atij duhet ti njihet pjesërisht e drejta në pagat të pa paguara për muajit mars 2003-mars 2005 në shumë prej 1,417.73 euro. Shkalla e I-rë konstaton se pagat për muajit dhjetor 2002, janar dhe shkurt 2003, janë parashkruar, andaj kjo pjesë e kërkesës për paga është refuzuar si e pa bazuar. Tutje shkalla e I-rë konstaton se me rastin e llogaritjes së tri pagave të papaguara, ajo është bazuar në Listën e pagave të mbetura borxh e datës 24 mars 2006. Shkalla e I-rë konstaton se paditësi i është njohur edhe e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës

së punës në shumë prej 567.28 euro, bazuar në përvojën e tij të punës prej 21 viteve e 11 muaj sipas kopjes së Librezës së punës.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij në Shkallën e I-rë ka sjell kopjen e Njoftimit të datës 24 mars 2006 e lëshuar nga AKM-ja mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, Kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 24.03. 2006, një liste të pagave të pa paguara të lëshuar nga ana e NSH-së, Listën për tri pagat e fundit të pa paguara, tre formularët e kërkesave dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit, kopjen e letërnjoftimit, dhe kopjet e tri Vendimeve të ankimuara të Autoritetit të Likuidimit.

Bazuar në këto prova të cilat janë të mjaftueshme, Kolegji i Apelit konsideron se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit dhe i kishte ndryshuar vendimet e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke detyruar AKP-në që të paguaj paditësit në emër të pagave të pa paguara për periudhën për muajin mars 2003-mars 2005 shumë prej 1,417.73 euro, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës për tej shumës së aprovuar e kishte refuzuar me të drejtë si të pa bazuar, pasi që kjo pjesë e kërkesës ishte parashkruar. Me pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit po ashtu me të drejtë është obliguar AKP-ja që ti paguaj paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës shumë prej 567.28 euro, si dhe në emër të tri pagave të fundit të papaguara shumë prej 1,255.87 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Edhe Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë se këto tri kërkesa të paditësit nuk janë parashkruar, pasi që këto kërkesa burojnë dhe kanë mbështetje në Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Paditësi bazuar në udhëzimet e dhëna në këtë njoftim ai me kohë është paraqitë në procedurën e likuidimit, kërkesat e të cilit pa të drejtë janë refuzuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumën prej 100 euro, me datën 16 mars 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 24 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
